

INTERSIG®

VIENNA INSURANCE GROUP

RAPORTI VJETOR 2019



Permbajtja

1. Tregu I Sigurimeve ne Shqiperi
2. Historiku I Kompanise
3. Intersig jashte Shqiperise
4. Partneret
5. Historiku Intersig Vig ne Shqiperi
6. Vendet ku operojme
7. Vlerat e Intersig
8. Vizioni dhe Misioni
9. Organizimi I Shoqerise
10. Struktura e Aksionereve
11. Principet e Menaxhimit
12. Stafi Intersig
13. Trajnime te Zhvilluara
14. Komentet nga stafi
15. Kapitali
16. Primet e Shkruara Bruto ne Sigurimin e Jo-Jetës
17. Dëmet e Paguara ne Sigurimin e Jo-Jetës
18. Primet e Shkruara Bruto nga Shoqëritë e Sigurimit të Jo-Jetës 2019
19. Dëmet e Paguara nga Shoqëritë e Sigurimit të Jo-Jetës 2019
20. INTERSIG ne tregun Shqiptar
21. Ndarja e Tregut ne Sigurimet e Detyrueshme dhe Vullnetare të Jo-Jetës
22. Sherbimet e ofruara
 - a. Sigurime Motorike
 - b. Sigurimi I Pasurise
 - c. Sigurimi I Shendetit
 - d. Sigurimi I Pergjegjesive dhe I Garancive
 - e. Sigurime ne Transport
23. Vleresimi dhe menaxhimi I Riskut
 - a. Vetëvlerësimi i Rreziqeve të Shoqërisë
 - b. Procesi i Kontrollit të Rreziqeve
24. Taksat dhe Tatimet ne Fushen e Sigurimeve
25. Evente te Rendesishme
26. Raporti I Auditit
27. Pasqyrat Financiare
28. Plani 2020-2023
29. Kontakt



Tregu i Sigurimeve ne Shqiperi

Gjate vitit 2019 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 4.11%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 695,015 mijë lekë duke arritur shifrën 17,617,588 mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në 1,350,075 duke shënuar një rritje me 3.18% krahasuar me vitin 2018.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 16,337,199 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 3.88% krahasuar me vitin 2018.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 1,237,276 duke shënuar një rritje në masën 5.20% krahasuar me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019, janë paguar gjithsej 6,377,264 mijë lekë dëme ose 8.58% më pak se gjatë vitit 2018.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2019 është rritur me 5,254 dhe arriti shifrën 48,971 nga të cilat 46,778 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 2,193 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.



Historiku i Vienna Insurance Group

1824-1938

- Rrenjet e grupit te sigurimeve datojne qe nga viti 1824, ku u themelua grupi me i vjeter i sigurimeve, Wiener Stadtische Austria, dhe nga i cili u formua me vone Vienna Insurance Group.
- Ne 1898, lindi paraardhesi i trete i Vienna Insurance Group, Städtische Kaiser Franz Joseph-Versicherungsanstalt

1939-1955

- Kolapsi i ekonomise Austriake ne fillim te Luftes se II Boterore e la Wiener Stadtische ne prag te rrenimit.
- Ne 1947, kompania nderroi emrin ne "Wiener Stadtische Wechselseitige Versicherungsanstalt"
- Ndertesa e pare e larte ne Austri – RINGTURM

1956-1989

- Ne 1958 – Primet ne Austri ishin te barabarta me vleren ekuivalente te 202 Milion Euro te diteve te sotme.
- Hapat fillestare drejt zgjerimit – ne 1964, Wiener Stadtische firmosen nje marreveshje bashkepunimi me kompanine e jetes Jupiter, dhe ne 1966 bleu 40% te aksioneve te Osterreich Volksfursorge AG"

1990-2007

- Zgjerimi ne Europern Qendrore-Lindore – Wiener Stadtische mori pjese ne themelimin e kompanise se sigurimit Cekosllovake Kooperativa ne Bratislave, 1 vit pas renies se Perders se Hekurt
- Prezantimi i grupit si brand "Vienna Insurance Group" u be ne fillim te 2006.

2008- Sot

- Bashkepunimi me Erste Group dhe rritja e biznesit te sigurimeve
- Nje rritje e suksesshme kapitali, pavaresisht krizes ekonomike. Krijohet VIG RE
- VIG blen kompani ne te gjitha vendet e Europes Qendrore dhe Lindore



Historia e Intersig Vig

2001

Intersig u themelua ne 2001 nga nje grup aksioneresh vendas te cilet moren licensen per nje kompani Jo-Jete ne Republiken e Shqiperise.

2001-2011

Intersig pati nje rritje te qendrueshme ne market share.

Viena Insurance Group bleu shumicen e aksioneve te Intersig Sh.a, ne baze te nje marreveshje te firmosur ne 24 Gusht 2011 ne Tirane

2011 – Sot

Aktualisht, **VIG** zoteron 90% te aksioneve te **Intersig VIG**. **Intersig** e cila u pajis gjithashtu me nje logo te re, dhe fakti qe eshte ne zoterimin e **VIG**, ka influencuar ne permiresimin e produkteve dhe sherbimeve te ofruara.

Intersig VIG ka reformuar shume procese duke investuar ne permiresimin e kualitetit te stafit dhe dixhitalizimin e shume proceseve.

Krijimi I produkteve te reja si Sigurimi i Shendetit, Easy Casco, etj jane bere pjese e portofolit te Intersig VIG.




Intersig ne Shqiperi

- Zyrrat Qendrore te Intersig VIG jane ne Tirane dhe Intersig VIG eshte I perfaqesuar ne te 13 rajonet e Shqiperise
- Kompania operon ne bazen e nje rrjeti te gjere te degeve, agjencie dhe pikave te shitjes
- Ne fund te 2018, kompania ka punesuar nje numer prej rreth 138 punonjesish



Vlerat e INTERSIG



Vizioni & Misioni

- **Vizioni**

Të jesh pjesë e një grupi udhëheqës të sigurimeve dhe shërbimeve financiare që kërkon vazhdimisht rritje të qëndrueshme si edhe për të rritur vlerën e ndërmarrjes. Ne dëshirojmë të jemi agjensia e sigurimit e zgjedhur, e përkushtuar për edukimin, shërbimin dhe mbrojtjen e familjeve dhe bizneseve vendore me politikat më të mira dhe me çmimin e duhur.

Vizioni ynë është të vendosim standardin e përsosmërisë midis ofruesve të sigurimeve duke qenë inovator, duke qenë i fortë financiarisht, duke siguruar mbështetjen dhe shërbimin e duhur për klientët tanë.

- **Misioni**

Dedikimi për të qenë kompania lider në Shqipëri në sajë të produkteve kompetitive dhe shërbimit me kualitet që ofrojmë. Përpiqemi që çdo ditë të veprojmë me integritet; kërkojmë dhe përqafojmë larminë; dëgjojmë, edukojmë dhe mësojmë; ofrojmë zgjidhje; gjenerojmë energji pozitive; dhe mbështesin komunitetin tonë.

Ne ofrojmë risi dhe përsosmëri në produktet dhe shërbimet tona. Në gjithçka që bëjmë, jemi të përkushtuar të shkojmë përtej pritshmërive. Gjithmonë do të mbetemi fleksibël dhe inovues, në mënyrë që të jemi në gjendje t'i adresojmë nevojat në varësi të klientëve tanë.


Ne krijojmë vlera solide.

Ndergjegjshmeria për CSR, është arsyeja pse INTERSIG është angazhuar në programe sociale dhe projekte të dedikuara kryesisht personave me mundësi të kufizuara si edhe fëmijëve, të cilët janë e ardhmja jonë.

Premtimi ynë: **Make Life Easy!**

Premtimi i VIG: **Protecting What Matters!**


Organizimi I Shoqerise



* Intersig VIG obtains (transferred) back office services from the company VIG Services Shqiperi, such as: Finance & Accounting; IT and Claim Handling.

** Services shared between two companies: Intersig VIG and Sigma Interlbanian, which are both part of Vienna Insurance Group.

Struktura e Aksionereve




Struktura e Keshillit Mbikeqyres :

Mr. Peter Hoefinger	Kryetar
Mr. Christoph Rath	Zv. Kryetar
Ms. Michael Hack	Anetar Bordi

Struktura e Bordit Drejtues :


Mr. Gentian Sula	Drejtore i Pergjithshem
Ms. Fitnete Sulaj	Anetar Bordi
Mr. Fatmir Berdica	Anetar Bordi

Principet e Menaxhimit



Stafi I INTERSIG

- Kombinimi I moshave te ndryshme me qellim nderveprimin e eksperiencave.
- Fokus ne stafin te ri dhe profesional
- Trajnime te vazhdueshme brenda dhe jashte Shqiperise
- Mundesi te barabarta per rritje ne karriere
- Motivim I larte



Trajnime te Zhvilluara


- Intersig Vienna Insurance Group ka zhvilluar trajnime te ndryshme per stafin me qellim rritjen e cilese se sherbimeve te ofruara, si brenda edhe jashte vendit, perfshi:

- Austri
- France
- Portugali
- Gjermani
- Hollande
- Maqedoni.



Kapitali

PRIME TE SHKRUARA FAKTIKE 2013-2018 DHE PLANI 2019-2021



Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Prime Mil						
ALL	6.28	10.38	15.68	16.01	16.66	16.78

VITI	2019	2020	2021
PRIME MIL EURO	18.14	19.06	19.72

Intersig VIG gjate vitit 2019 ka shkruar rreth 18.14 milion Lekprime. Numri i kontratave te realizuara eshte 130 mije ose 5 % me shume se 2018.


Intersig VIG gjate vitit 2020 ka planifikuar te realizoje 19.06 milion ALL Prime te shkruara.

INTERSIG ne tregun Shqiptar

Intersig ka 11% te tregut per Primet e Shkruara ne vitin 2018 me rreth 13,7 mil euro.


Intersig ka paguar rreth 4.9 Mil Euro Deme gjate vitit 2019. Numri i kerkesave te Demeve te paguara nga Intersig gjate 2018 eshte 9'716 ose 23% e te gjithe kerkesave te tregut.

Tregu per Primet e Shkruara
Bruto




■ Intersig

Demet e paguara ne Vlere



■ Intersig ■ Others

Demet e Paguara ne Numer



■ Intersig ■ Te Tjeret

Sherbimet e ofruara


SIGURIME NË TRANSPORT

SIGURIMI I SHËNDETIT

SIGURIMI I PASURISË

SIGURIME MOTORIKE

SIGURIMI I PËRGJEGJËSIVE DHE I
GARANCIVE



Vleresimi dhe menaxhimi I Riskut

Vetëvlerësimi i Rreziqeve të Shoqërisë

Procesi i Kontrollit të Rreziqeve

Prova e Rezistencës

Administrimi i Rrezikut Financiar

Administrimi i rrezikut të sigurimit



Vetëvlerësimi i Rreziqeve të Shoqërisë

Procesi i vetëvlerësimit të rreziqeve të shoqërisë përbëhet nga disa faza:



- a. Identifikimi i rreziqeve
- b. Kuantifikimi
- c. Planifikimi
- d. Ndërmarrja e rreziqeve
- e. Mitigimi
- f. Monitorimi
- g. Reagimi




Procesi i Kontrollit të Rreziqeve

Këto janë risqet (perfshirë dhe kategoritë e nën-risqeve) tek të cilat fokusohet dhe analiza e vetëvlerësimit.

Risku i marrjes në sigurim

Risku operacional

Risku i tregut



Taksat dhe Tatimet ne Fushen e Sigurimeve

INFORMACION PER TAKSAT DHE TATIMET E ZBATUESHME NE FUSHEN E SIGURIME:

Për kontratat e sigurimit, Primet e sigurimit janë të zbatueshme taksat dhe tatimet si më poshtë:

LIGJ Nr. 92/2014 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
Neni 53 “Përjashtime për disa veprimtari të tjera”

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

- a) shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit.

LIGJ Nr.9975, datë 28.7.2008 PËR TAKSAT KOMBËTARE I NDRYSHUAR

Neni 4 Niveli i taksave Kombetare

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është **10 për qind e shumës së primit.** (Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016).

Për pagesat e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve nuk aplikohen taska/tatime për shkak se nuk konsiderohen të ardhura.

Evente te Rendesishme

Viti Kulturor Austri – Shqiperi → GRAND GALA "ALLES WALZER" (PREMIERI ABSOLUTE)

Ballo vjeneze në Tiranë

Vllaznia Basketball Club

Termeti ne Durres



GRAND GALA "ALLES WALZER"

Ne kuader te Vitit Kulturor

Austri – Shqiperi

GRAND GALA "ALLES WALZER"

PREMIERI ABSOLUTE

Në Pallatin e Kongreseve, më 28 dhjetor, ora
19:00



Ballo vjeneze në Tiranë

Ballo vjeneze në Tiranë

Me kohën kanë ndryshuar shumë gjëra, por një gjë mbetet absolute. Valsi gjithherë ka qenë simbol i klasit dhe fisnikërisë. Si i tillë ai merr një kuptim më të veçantë nën moton Vals për Jetën, në edicionin e dytë të Ballos Vjeneze në Tiranë.

Një event madhështor nën kujdesin e Ambasadës Austriake bëri bashkë në Tiranë njerëz të medias, biznesit e politikës, në një natë të madhe kushtuar klasikëve dhe valsit. 'Exclusive' ndjek hap pas hapi valsit vjenez që nga konsolidimi i tij përgjatë Kongresit të Vjenës e deri më sot ku njëherë në vit Eiener Staatsoper shndërrohet në dhomën më të bukur dhe elegante të Ballos të Operës së Vjenës.



Vllaznia Basketball Club

Vllaznia Basketball Club

Intersig, sponsori zyrtar I Klubit te Basketbollit Vllaznia.

Kompania mbetet cdo dite e motivuar qe t'ju mundesoje nje jete ku te papriturat festohen !



Termeti ne Durres, INTERSIG ju gjendet prane gjithmone !

Termeti ne Durres

Stafi Intersig ka kryer kontrollin dhe u eshte gjendur prane mijera qytetare

Duke dhene kontributin e saj per te lehtesuar sadopak dhimjen e qytetare

Korrektesia dhe profesionalizmi ndaj subjekteve dhe qytetareve nuk kane munguar ne asnje moment !



Raporti I Auditit

Përmbledhje e aktivitetit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2019 në shoqërinë Intersig VIG është kryer në përputhje me Planin Vjetor të Auditit të Brendshëm, të miratuar në Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë në muajin Dhjetor 2018, si dhe me Planin tre-vjecar të Auditimit të Brendshëm 2019 – 2022, të përditësuar bazuar në analizën më të fundit të risqeve dhe të miratuar nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm të Grupit Vienna Insurance Group.

Organizimi i funksionit të Auditimit të Brendshëm në Shoqërinë e sigurimit Intersig VIG është bazuar në këto rregullore:

- Karta e Auditit të Brendshëm, e miratuar nga Bordi Drejtues i Shoqërisë
- Manuali i Auditit të Brendshëm
- Parimet kryesore e Auditit të Brendshëm të Vienna Insurance Group
- Rregullore Nr. 153 të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit”.

Gjatë vitit 2019 Departamenti i Auditit të Brendshëm ka audituar aktivitetet e shitjes, të marrjes në sigurim, të menaxhimit të riskut, të trajtimit të dëmeve, të risigurimeve, të administrimit, të finances dhe të teknologjise se informacionit.

Ne angazhimet audituese janë përfshirë departamentet në zyrat qendrore dhe degët e shoqërisë dhe duke mbuluar kështu plotësisht të gjithë veprimtarinë e saj.



Aktivitetet e shitjes drejtohen nga Departamenti i Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme dhe kryhen nga Zyrat Qëndrore, nga Degët e Shitjeve dhe Ndërmjetesit e licensuar të shitjes të shoqërisë Intersig VIG.

Kontrollet e Auditit të Brendshëm për vitin 2019 në aktivitetet e shitjes janë fokusuar në zbatimin rregullores së brendshme të shoqërisë, rregjistrimin e saktë dhe pa vonesa të policave të sigurimit në programin e shitjes, arketimin e primeve vecanërisht për produktet vullnetare, menaxhimin e llogarive të parashënimeve për shitjen, duke u bazuar edhe në kërkesat e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për rregjistrimin dhe raportimin në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm.

Gjithashtu puna audituese është përqendruar në zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të brendshme të Bordit Drejtues lidhur me menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve të shitjes, procedurat e marrjes së agjenteve të rinj dhe largimin e agjenteve egjistues, etj.

Kontrollet e shitjes së produkteve të detyrueshme, TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare janë përqendruar më së shumti tek risqet e mundshme që shfaqen si pasojë e gabimeve në rregjistrimet e policave të shitura në programin e shitjes, në saktësinë e të dhënave lidhur me kategorinë e automjetit, periudhën e sigurimit etj.



Aktivitetet e marrjes ne sigurim dhe menaxhimit te riskut gjate vitit 2019 kane funksionuar te harmonizuara me njera tjetren. Per cdo rast Komitet i Menaxhimit te Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen ne sigurim dhe ofertat per percaktimin e primit ne perputhje me rregulloren e brendshme dhe urdhrat e Bordit te Drejtoreve te nxjerra per kete qellim. Shoqeria i ka kushtuar vemendje dhe ka permiresuar dokumentacionin e nevojshme per analizimin e risqeve te marrjes ne sigurim te pronave.

Funksionet e trajtimit te dëmeve, të kontabilitetit dhe të teknologjisë së informacionit janë transferuar në një kompani sherbimi, **VIG Services Shqiperi**. Kriteret e ofrimit te sherbimeve te transferuara dhe treguesit e performances jane te percaktuara ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit (SLA Agreement) ndermjet shoqerise Intersig VIG dhe VIG Services Shqiperi. Kjo marreveshje eshte perditesuar ne muajin Tetor 2017 dhe per pjese te vecanta ne menyre te vazhdueshme.



Auditimet e realizuara gjate vitit 2019 ne **aktivitetet e trajtimit te demeve** jane fokusuar ne zbatueshmerine e ligjeve ne fuqi, Rregulloreve te AMF dhe Rregulloreve te brendshme te miratuara nga shoqeria.

Kontrollet e Auditit te Brendshem gjate vitit 2019 kane synuar te mbulojne te gjitha llojet e demeve te raportuara, (te paguara gjate vitit dhe ato pezul), si ato materiale, motorrike (Kasko dhe TPL); dëmet e prones, ashtu edhe dëmet jomateriale, shendetsore nga TPL, dhe dëmet e sigurimit privat te shendetit. Kontrollet e kryera ne Departamentin e Demeve, VIG Services, jane fokusuar ne korrektesine e ekspertimit dhe saktesine e vleresimin te demeve; ne funksionimin e kontrollit te proceseve brenda departamentit; ne kohezgjatjen e trajtimit te demeve dhe ne kujdesin per klientin.

Gjate auditimeve jane kontrolluar si databaza elektronike, regjistrimet ne programin e demeve dhe dokumentat e skanuar elektronikisht, ashtu edhe dokumentacioni fizik i arkivuar i dosjeve te demeve te paguara.

Kontrollet ne trajtimin e demeve materiale nga produktet e detyrueshme kane konsistuar ne afatet e regjistrimit dhe trajtimit ne perputhje me rregulloret e AMF, problematikave lidhur me funksionimin dhe permiresimin e programit informatik te trajtimi te demeve; ne referencat dhe manualet e cmimeve te perdorur per vleresimin e sakte dhe te drejte te demeve dhe kryerjes ne kohe te pageses se demshperblimit.



Permbushja e funksioneve te Departamentit te Administrimit është audituar gjatë vitit 2019 duke u fokusuar ne: grumbullimin dhe dorezimin ne Byro te policave te detyrueshme TPL, KJ dhe KUF (polica te furnizuara gjate vitit 2019 dhe te pashitura deri ne fund te vitit); rakordimet mujore te agjenteve te shitjes me deget dhe me drejtorine e pergjithshme; ne analizimin, ndjekjen dhe arketimin e primeve e paarketuara; ne kontrollin e inventarimin fizik te policave gjendje te furnizuara tek agjentet e shitjes; ne zbatimin e procedurave per leshimin e policave dublikate dhe anullimin e policat; ne funksionimin e programit Edusoft per administrimin e policave (rregjistrimi dhe raportimi ne nivel police, i primeve, arketimeve, debitoreve, komisioneve dhe inventarit); si dhe ne llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve ne perputhje me urdhrat e brendshme te Bordit te Drejtoresh te Shoqerise.

Administrimi kontabël i shoqerise eshte audituar per sakesine e rregjistrimeve ne programin e kontabilitetit SAP ne Departamentin e Kontabilitetit, VIG Services. Jane kontrolluar si edhe raportimet brenda afateve ne insitucionet jashte shoqerise (AMF, DPT, Drejtoria e Pastrimit te Parave etj.), si dhe raportimet e brendshme per Departamentet e tjera, Bordin Drejtues dhe Keshillin Mbikqyres.



Departamenti i Teknologjise se Informacionit gjate vitit 2019 eshte audituar lidhur me shfrytezimin e sistemeve dhe programeve informatike ne perputhje me rregulloren e brendshme, implementimin e programit te ri te shitjes, administrimit dhe demeve (MBA), aplikimin e sakte te hierarkise se te drejtave te perdoruesve, rinovimin e pajisjeve hardware dhe perditesimin e licencave ne perdorim, dhenien e suportit IT per te gjithë perdoruesit e sherbimeve (punonjesit) si dhe mirembajten e sistemeve te sigurise te instaluara ne ambjentet e shoqerise

Nga kontrollet ne Departamentin e **Ri-sigurimeve** ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar ne Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ne Rregulloren e Grupit VIG per Risigurimet dhe ne marreveshjet e lidhura ndermjet shoqerise dhe risiguruesve perkates. Partneri kryesor per aktivitetin e risigurimeve eshte VIG-RE i cili eshte pjese e Vienna Insurance Group. Partneret e tjere jane perzgjedhur dhe miratuar bazuar ne rankimet nderkombetare te institucioneve nderkombetare per shoqerite e risigurimeve. Lista e risiguruesve eshte perditesuar periodikisht ne perputhje me rregulloren e brendshme te Grupit VIG.



Kontrollet e auditit te brendshem kane konsistuar ne perpushmërine ligjore dhe te zbatimit te rregulloreve ne fuqi, njoftimin ne kohe dhe miratimin nga ana e Departamentit te Risigurimeve te Grupit VIG lidhur me risqet e mundshme dhe percaktimin e ofertave. Gjithashtu jane audituar raportimet periodike në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe në Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Veprimtaria e **Departamentit Ligjor** eshte fokusuar ne përfaqësimin dhe mbrojten e shoqerise ne proceset gjyqesore me objekt trajtimin e demeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato te fondit te kompensimit. Gjithashtu pjese e aktiviteteve juridike te shoqerise jane ndjekja dhe mbeshtetja per grumbullimin primet e paarketuara nga klientet dhe subjektet debitore.



Dhënia e sigurisë së audituesit të brendshëm mbi aktivitetet e shoqërisë gjatë vitit 2019

Angazhimet audituese të realizuara gjatë vitit 2019 kanë mbuluar të gjitha aktivitetet e shoqërisë dhe janë finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë pasqyruar në raportet e auditimit të dërguara në Bordin Drejtues të Shoqërisë Intersig VIG sh.a dhe në Këshillin Mbikqyrës të saj.

Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit, Departamenti i Auditit të Brendshëm të shoqërisë Intersig VIG ka arritur siguri të arsyeshme që aktivitetet e shoqërisë Intersig VIG gjatë vitit 2019 janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të tregut të sigurimeve në Shqipëri. Në angazhimet tona audituese nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të konsiderueshme, të cilat të kenë një impakt domethënës material në aktivitetin e Shoqërisë.

Drejtori i Auditit të Brendshëm ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Komitetin e Auditimit dhe Bordin Drejtues, duke marrë mbështetje të plotë për realizimin e rekomandimeve. Në mënyrë të vazhdueshme Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve të miratuara dhe statusin përfundimtar të tyre.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm

Pasqyrat Financiare



Intersig Vienna Insurance Group SH.A

**Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2019**

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionarëve të Intersig Vienna Insurance Group SH.A:

Opinionit ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Intersig Vienna Insurance Group SH.A ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 December 2019;
- pasqyrën e të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e të flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera përbëhen nga skedulet suplementare të cilat përfshijnë aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike (por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit).

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Regjistruar në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit më 15 korrik 2009 dhe me Numër Tatimor Identifikimi NUIS K91915023A

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar të raportojmë këtë çështje. Ne nuk kemi diçka për të raportuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e drejtimin dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticism profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

